

-
=



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 1241/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muharrem Shala kryesues, Xhevdet Abazi dhe Hasan Shala anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesat e Fadil Halili – Kandidatë për Anëtarë të Kuvendit Komunal (LDK) dega në Ferizaj, paraqitur kundër Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ), për shkak të mungesës së votave, të zgjedhjeve lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 06.12.2013, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohen si të pabazuara ankesat: Anr.1241, Anr.1242, Anr.1258, të datës 03.12.2013, të Fadil Halili – Kandidatë për Anëtarë të Kuvendit Komunal (LDK) dega në Ferizaj.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar ankesat: Anr.1241, Anr.1242, Anr.1258 të datës 03.12.2013, të Fadil Halilit nga Ferizaji. në të cilat ankesa pretendon se dyshon për se ka pasur keqpërdorime dhe mungesë të votave.

- Në ankesën Anr.1241/13 të datës 03.12.2013, ka pretenduar se në VVnr.2 në QV 2515D/02R më mungojnë 3 vota bazuar sipas raportit vëzhgues të LDK-së. Më tutja ka theksuar se, kërkoi që të rinumërohen votat e VV nr.1 në shkollën Tefik Qanga i njëjti vendvotim 2501D/01R mungon 1 votë, dhe fiuron në raportin e vëzhguesve prandaj kërkoi rinumërimin e votave. Për më tepët ka theksuar se, në VV nr.2 në fsh. Pleshinë 2506D/02R mungon një votë e cila figuron në raportin e vëzhguesve kërkoi rihapjen dhe rinumërimin e votave. Në cilësi të provës parashtruesi i ankesës e i ka bashkangjitur formularë e raportit nga Shtabi Zgjedhor.
- Në ankesën Anr.1242/13 të datës 03.12.2013, pretendohet se në VV 2501d/06R, QV 25017/01R, QV2502D/04R kërkoi që të rihapen dhe rinumërohen votat.
- Në ankesën Anr.1258/13 të datës 03.12.2013, pretendohet se, në VV 2534D/01R, VV2512D/01R kërkoi që të rihapen dhe rinumërohen kutitë e këtij vendvotimi pasi që më mungojnë disa vota.

Bazuar në nenin 6.3 të “Rregullave dhe Procedurave” të PZAP-it, në të cilin parashihet se: “Me qëllim të lehtësimit të shqyrtimit të ankesave, Kryesuesi i Panelit mund të vendos ta bëjë bashkimin e ankesave që përmbajnë në vete çështje të ngjashme, paneli vendim-marrës i trajton ato ankesa sikurse të ishin një ankesë”. Në rastin konkret Kryesuesi i Panelit duke u bazuar në dispozitën ligjore të lartcekur ka vendosur ti bashkoi ankesat e sipërsënuara dhe ti trajtoi si një ankesë.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi ankesat gjeti se:

Ankesat janë të pa bazuara

Pretendimet ankimore nga ana e Fadil Halilit – Kandidatë për Anëtarë të Kuvendit Komunal në Ferizaj, paraqitur kundër Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ) , ku dyshohet për pa rregullsi dhe keqpërdorime si dhe munges të konsiderueshme të votave nëpër QV, mirëpo nuk është ofruar asnjë provë relevante nga ana e palës ankuese, me të cilat do të mund të vërtetoheshin shkeljet e supozuara.

Prandaj për shkakun se nuk janë ofruar dëshmi bindëse për të vërtetuar se kanë ndodhur dhe janë evidentuar pa rregullsi dhe keqpërdorime gjatë procesit të votimit në QV, të lartcekura nga parashtruesi i ankesës, PZAP-i konstatoi se pretendimet ankimore janë të përgjithshme dhe të pa qarta për tu vërtetuar dhe ankesat e lartpërmendura u refuzuan si të pa bazuara, prandaj duke u bazuar në nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesat e lartë përmendura u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

A nr. 1241/2013 më datën 06.12.2013



Këshillë juridike: Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda 24 orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.